

Dr. Xheladin SHALA

KRYENGRITJA NË KOSOVË KUNDËR SERBISË NË MUAJT MAJ-QERSHOR TË VITIT 1919

Historiografia shqiptare deri vonë nuk u ka kushtuar rëndësi të duhur kryengritjeve shqiptare kundër pushtuesve serbo-malazezë dhe për rrjedhojë ende nuk janë ndriçuar sa duhet figurat qendrore të luftërave shqiptaro-serbe. Vetëm gjatë dekadës së fundit të shek. XX dhe në këto 5 vjet të fillimshkullit XXI po bëhen përpjekje për t'i zbardhur çështjet më madhore të popullit tonë.

Pasi çështja e luftërave shqiptaro-serbe nuk është ndriçuar drejt dhe plotësisht, është kërkesë imediate që, për shkak të interesit të tanishëm kombëtar dhe para së gjithash atij shkencor, t'i qasemi problemit në bazë të burimeve arkivore dhe ta paraqesim në mënyrë të gjithanshme pjesën më të guximshme dhe më të lavdishme të popullit tonë, që rezistoi dhe u sakrifikua në luftë kundër pushtuesit serb. Pra, ka ardhur koha që ta afirmojmë para opinionit tonë ngjarjen e rëndësishme sikundër ishte Kryengritja e pranverës e vitit 1919. Shpresojmë që ky punim i shkurtër të jetë një kontribut modest për historiografinë shqiptare.

Të shkruash për luftëtarët, për çlirimtarët dhe sakrifikuesit shqiptarë nuk është vetëm një nder dhe privilegj i veçantë, por është edhe obligim e madje edhe krenari kombëtare.

Lufta e Parë Botërore kishte përfunduar për botën në nëntor të vitit 1918, por jo për shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë në përgjithësi. Shqiptarët jashtë kufijve politikë të vitit 1913 u rirobëruan nga Serbia me ndihmën e Francës, ndërsa Shqipërinë e vitit 1913 e shkelën sërish ushtritë e huaja. Mjerisht, rrethanat ndërkombëtare ishin prapë në favor të Serbisë, e cila atëbotë ishte e përkëdhelura e Ballkanit.

Ripushtimi serb solli pamje trishtuese në fshatrat dhe në qytetet e Kosovës. Mirëpo, Azem Bejta dhe Shotë Galica me luftëtarët e njësitit të tyre ndërmorën hapa kundër pushtimit të ri. Edhe Sadik Rama me bashkëluftëtarët, si Ramadan Shabani, Zef Gjijoda, Met Ymeri etj.

organizuan çeta të armatosura dhe e kundërshtuan vendosmërisht politikën serbomadhe.¹ Gjithashtu, rezistencë u bë edhe në shumë krahina të tjera të Kosovës. Populli i Plavës, Gucisë dhe i Rugovës kishte vendosur për luftë, e jo nënshtrim.² Haptazi kërkuan bashkim me Shqipërinë e lirë dhe me çdo kusht. Mirëpo, kundër këtyre krahinave u vërsulën me dhjetëra mijë ushtarë serbë e malazezë dhe nga fundi i muajit shkurt mbi popullatën shqiptare u bë një mizori e paparë.³ Rezulatti ishte: qindra të vrarë dhe qindra të plagosur. Ato krahina shqiptare përjetuan episodin e tragjedinë më të madhe në histori.⁴ Serbia konsideronte se e kishte zëvendësuar Austro-Hungarinë si faktor për ta "rregulluar" Ballkanin e për ta drejtuar fatin e tij. Shteti serb brenda një periudhe shumë të shkurtër historike prej 40 vjetësh kishte pasur tri herë zgjerime tokësore. Nga 37.700 km, sa kishte më 1877, dhe mbi 1 milion banorë, deri më 1918 Mbretëria SKS arriti një sipërfaqe prej 248.000 km dhe 12 milionë banorësh. Në këtë hapësirë shtetërore tashmë të zgjeruar përfshihej edhe më shumë se gjysma e tokave dhe populli shqiptar.⁵ Në shumë anë të Kosovës veglat e pushtetit serb u pritën me fjalët: "Qysh mundet me iu emnue pushteti serb, kur këtu do të bahet Shqipni".⁶ Popullin e Kosovës si rrufetë e kanë goditur fatkeqësi të shumta dhe shpesh shpirti i ka ardhur në majë të hundës. Kufiri i Kosovës disa herë është përgjysmuar. Serbia, vend tipik i shtypjes brutale kombëtare, u tregua tepër e vrazhdë sidomos ndaj shqiptarëve, të cilët duke mos u pajtuar me robërinë nuk i lëshuan armët nga dora. Lufta shqiptaro-serbe për afro dy shekuj ka shënuar ngritje e rënie, por kurrë nuk është ndalë deri në fillim të shekullit XXI. Ishte një fatkeqësi e madhe për shqiptarët e Kosovës që e kishin në kufi Serbinë, sidomos gjatë dy dyshekujve të fundit.

Kështu, Miss Edit Durham, si njohësja më e mirë e historisë së popujve të Ballkanit, megjithëse ishte mike e Serbisë dhe Malit të Zi, pas luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, përkitazi me ato që pa në hapësirat ballkanike, deklaroi: "Pushtuesit serbë ishin njëqind herë më të këqij se

¹ Jetish Kadishani, Sadik Rama – Gjurgjevik (1872-1944), Prishtinë, 2003, 125.

² Mr. Lush Culaj, Komiteti MKK 1918-1924, Prishtinë, 1997, 65.

³ Arhiv vojno istorijkog instituta, Beograd, Popisnik 3, kutija 163, fasc. 3, br. 18780; Xheladin Shala, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1918-1924, punim magjistrature, Prishtinë, 1979, 46.

⁴ AVII, Beograd, Popisnik 3, kutija 163, fasc. 3, br. 269; Xheladin Shala, vep. e cit., 46; AQSh, fondi 846, dosja 45, nr. 708-650: mbreti Aleksandër i Serbisë si armik i përjetshëm i shqiptarëve në muajt e parë të vitit 1919 deklaroi: "Me mësyje Plavën e Gucinë dhe me i rrënue, qoftë edhe me sopata në mos mjaftojnë topat".

⁵ Bajram Xhafa, Lufta e Dibrës 1920, Shkodër, 2001, 69-70.

⁶ AVVI, Beograd, popisnik 6, kut. 62, fasc. 4, br. 171; Limon Rushiti, Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928, Prishtinë, 1981, 72; Xheladin Shala, vep. e cit., 44.

turqit”.⁷ Pra, shkaktar numër një i tragjedisë kombëtare shqiptare në Kosovë ishte serbo-sllavizmi. Për shkak të gjendjes së padurueshme, në muajt e parë të vitit 1919 shqiptarët i dolën përballë rrezikut të quajtur Serbia e dytë. Në prag ishte shpërthimi i stuhisë së një kryengritjeje të fuqishme çlirimtare. Shtyllat e rëndësishme kombëtare, si Drenica, Llapusha, Rrafshi i Dukagjinit, Dibra, Plava, Gucia, Rugova, Llapi e zona të tjera, ishin në këmbë në pranverë të vitit 1919. Ato nuk mund të duronin që më tepër se gjysma e kombit të konsiderohej minoritet nga Serbia.

Azem Bejta dhe Sadik Rama ishin flamurtarë të kryengritjeve në pranverë të vitit 1919 në Kosovën e djegur e të pjekur në zjarrin e robërisë për shekuj me radhë. Për t’iu ardhur në ndihmë luftëtarëve shqiptarë, Komiteti MKK në krye me Kadri Prishtinën, përpiloi Programin e përgjithshëm të kryengritjes në Kosovë që kishte 6 nene. Parimi i Komitetit MKK ishte - një komb-një shtet, më çka kërkohej zbatimi i drejtë i parimit të vetëvendosjes së popujve.⁸

Derisa shqiptarët e Kosovës përpiqeshin të krijonin një Shqipëri me kufijtë e saj vërtet kombëtarë, qëllimi i Serbisë ishte çrrënjësja e idesë së çlirimit dhe të bashkimit kombëtar shqiptar.

Komiteti MKK në prill të vitit 1919 i kishte hartuar 11 kërkesat e kryengritësve të Kosovës drejtuar Serbisë pushtuese.⁹ Megjithëse numri i çetave kryengritëse vinte duke u shtuar lufta e tyre kufizohej në aksione lokale. Në ato rrethana lindi nevoja e një ndërlidhjeje dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre. Këtë e parashtrroi edhe Komiteti MKK më 24 prill 1919, kur iu bë thirrje shqiptarëve të Kosovës për kryengritje.¹⁰ Thirrjet u shpërndanë anekënd Kosovës nëpërmjet anëtarëve besnikë të Komitetit MKK. Në rrethana të tilla pushteti i Serbisë krahas dhunës së hapur nuk e la pa e përdorur edhe dredhinë, rrugën e mashttimeve dhe të kërcënimeve. Sadik Rama u tha troç emisarëve të Beogradit: “Kosova asht një tokë Shqipnise dhe ka me fitue indenpendencën.”¹¹ Sadiku ishte një atdhetar i njohur në Kosovë

⁷ Bajram Xhafa, vep. e cit., 216.

⁸ AQSH, fondi 846, dos. 1, nr. 708-045; Eqber Skëndi, Hoxha Kadriu, Prishtinë, 1992, 48; Muin Çami – Gazmend Shpuza, Komiteti MKK, “Zëri i popullit”, Tiranë, 7.11.1978.

⁹ AQSH, fondi 846, dos. 29, nr. 22.

¹⁰ AQSH, fondi 846, dos. 46, nr. 409; Limon Rushiti, vep. e cit., 95; Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë, 1976, 72-73: Pos tjerash thuhej: “Vllazen koha asht tepër me randësi. S’keni asni minutë për të kapërcyer në gjumë. Nevoja asht e madhe e na shtyn me u shtrengue në ni vllazmin e në ni bashkim të patundshëm... Duhet me u gati ditës mrame... pra, kush të dojë me nderue vedin, shpinë e atdheun lëe të përpiqet pa bjerë asni minutë rreth e qark deshirat kombëtar tue këshillue popullin me u bashkue e tue shty atë me u ba gati nevojave të nesërme”.

¹¹ Jetish Kadishani, vep. e cit., 419.

që nuk kishte lënë tubim apo betejë të njohur çlirimtare pa marrë pjesë. Serbia nxori edhe vendim për vrasjen e komandantëve të çetave: Azem Galicës, Sadik Ramës, Ramadan Shabanit, Mehmet Konjuhiti etj. si dhe preftoi shpërblime për vrasësit.¹²

Gjatë 28-29 prillit të vitit 1919 zhvillohet një luftë në fshatin Radishevë, ku u ndodhën Azem Bejta dhe Shotë Galica me luftëtarët çlirimtarë.¹³ Natën e 5 majit 1919 Azem Bejta me njësitin e vet rrethoi qendrën administrative të Drenicës - Devičin dhe në mëngjes më 6 maj e sulmoi qendrën në fjalë, me ç'rast u zhvillua një betejë e madhe. Kryengritëja filloi në të njëjtën ditë, më 6 maj 1919, ditën e Shëngjergjit edhe në krahinën e Llapushës dhe në rrethinën e Pejës, ashtu siç ishin marrë vesh udhëheqësit e Kryengritjes Azem Bejta, Sadik Rama etj.

Pra, kryengritja shqiptare në Kosovë shpërtheu përmjherë dhe në shumë krahina kryengritësit e morën pushtetin në duart e tyre. Kështu, në javën e parë të majit 1919 në Drenicë dhe në Dukagjin u pozicionuan përballë njëra-tjetrës dy ushtri: ushtria e kryengritësve shqiptarë të Kosovës dhe ushtria pushtuese e Serbisë.¹⁴ Krahinat shqiptare, të shkëputura arbitrarisht më 1913 prej trungut të vet, u ngritën për të gjashtën herë me armë në kryengritje kundër Serbisë për pesë vjet: 1912, 1913, 1914, 1915 dhe dy herë më 1919. Kryengritja shqiptare që shpërtheu më 6 maj 1919 në Kosovë eruptoi si lavë vullkani. Nga raportet e shumta ushtarake të Serbisë kuptohet se në Kosovë vlonte një kryengritje e fuqishme kundër saj.¹⁵ Luftëtarët çlirimtarë drejtoheshin nga një shtab me Azem Bejtën e Sadik Ramën në krye. Shtabi ishte në Gjurgjevik dhe më vonë në Sferkë të Gashit. U çliruan të gjitha fshatrat ndërmjet Rahovecit, Drenicës, Pejës dhe Istogut (Burimit).

Nga mesi i majit 1919 në Kosovë numëroheshin rreth 10.000 luftëtarë çlirimtarë.¹⁶ Pas disa javë luftimesh shqiptaro-serbe, me sulme e kundërsulme nga të dyja anët, ku pat shumë të vrarë e të plagosur, Beogradi i ndërpreu përkohësisht veprimet ushtarake dhe kërkoi të zhvillonte bisedime me udhëheqësit e Kryengritjes. Në realitet, qëllimi i tij ishte sjellja e forcave të reja në Kosovë, pushimi dhe ripozicionimi, pasi që nga lufta disajavëshe forcat e tij ishin rraskapitur. Kosova me luftëtarët dhe udhëheqësit trima po tregohej madhështore, e papërkulur. Nuk u besonin

¹² Eqber Skëndi, vep. e cit., 52.

¹³ Shotë Gacila heroinë e kombit, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, 38; Limon Rushiti, vep. e cit. 96-97.

¹⁴ Ajet Haxhiu, vep. e cit., 74.

¹⁵ AVII, Beograd, Popisnik 4/III, kut. 54, fasc.2, br. 2145; Xheladin Shala, vep. e cit., 48.

¹⁶ Ajet Haxhiu, vep. e cit. 75-76; Eqber Skëndi, vep. e cit., 52; Limon Rushiti, vep. e cit. 99; Xheladin Shala, vep. e cit. 49.

bisedimeve me Serbinë mashtruese, andaj vendosën ta vazhdonin luftën deri në fund, duke mos pranuar kurrfarë marrëveshjes me armikun pa e tërhequr ai ushtrinë nga Kosova. Serbisë nuk i konvenonte që të marrë jehonë ndërkombëtare lufta shqiptaro-serbe. Shteti MSKS solli forca të reja dhe të shumta ushtarake nga Shkupi dhe Nishi. Kosova u vendos në gjendje shtetrrrethimi.¹⁷ Prijësit e Kosovës kishin vendosur të dilnin faqebardhë përpara historisë. Më 6 qershor 1919 forcat çetnike dhe ushtarake serbe i goditën pas shpine kryengritësit në të gjitha anët. Më 7-8 qershor luftëtarët shqiptarë u sulmuan në rrethinën e Rahavecit, qytet i cili u dogj nga ushtria serbe. Në luftimet e fundit u përdorën 13 topa dhe 22 mitraloza, disa dhjetëra mijë forca, ku u vranë më se 600 kryengritës. Edhe ushtria serbe pati humbje të konsiderueshme. Beteja rreth Rahovecit dhe Gjurgjevikut të Madh ishte vendimtare për kryengritjen. Nga ajo kohë filloi të bjerë intensiteti i luftimeve. Një pjesë e kryengritësve u shpërnda në grupe të vogla nëpër male, një pjesë u detyrua të vendosej në Shqipërinë e 1913-ës. Kundër kryengritjes u përdorën njësitet më elite të artilerisë. U dogjën dhe u rrënuan rrafsh me tokë të gjitha fshatrat në të dy anët e Drinit të Bardhë. Vetëm në rrethin e Rahavecit u dogjën mbi 20 fshatra dhe u vranë qindra burra, gra, pleq e fëmijë.¹⁸ U bë plaçkitje e madhe e përcjellë me mizori. Shpërtheu i gjithë vleri shoven serbomadh.¹⁹ Mirëpo, shpresa për liri ekzistonte nën jehonën e krismave të pushkëve, sepse e këtillë ishte historia e kësaj treve.

Pa mëdyshje Kryengritja e pranverës e vitit 1919 është kryengritja më e njohur shqiptare në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore. Kah mesi i qershorit të vitit 1919 Qeveria e Durrësit ia dërgoi delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris një telegram lidhur me ngjarjet dramatike në Kosovë²⁰, i cili bëri efektin e tij dhe brengosi shumë serbomëdhenjtë meqenëse u qartësua shumëçka për Konferencën e Parisit. Sipas udhëzimeve të Pashiqit u kërkua që të shmangej gjakderdhja me shqiptarët, ndërsa pas përfundimit të Konferencës, pohonte ai, do t'i kemi duart të lira për aksione kundër tyre. Në fillim të korrikut, Këshilli i Ministrave në Beograd e analizoi situatën në territoret e okupuara të ish-Vilajetit të Kosovës, duke e konsideruar si shumë delikate dhe tepër acaruese. Aty nënvizoihej: “Çështja e amautëve (shqiptarëve në ish-Vilajetin e Kosovës, Xh. Sh.) do të udhëhiqet sipas një direktive dhe platforme tjetër, e jo si deri tash qysh është vepruar, pasi çështja amaute fitoi dhe zuri një hapësirë nga jehona e saj. Ajo

¹⁷ Gazeta “Populli”, 7-15, qershor dhe korrik 1919, Shkodër.

¹⁸ Ajet Haxhiu, vep. e cit., 76, 81; Xheladin Shala, vep. e cit. 49-50.

¹⁹ Skënder Drini, Bajram Curri, Tiranë, 221-222.

²⁰ DASSIPJ, kut. 7, fasc. 28, br. 2258; Xheladin Shala, vep. e cit. 50.

mori formë shumë të ndieshme. Për atë arsye duhet përmbytur shumë dhe asgjë të mos iu komunikohet aleatëve për këtë problem pa konsultime paraprake me ministrin e Luftës gjeneral Haxhiqin”.²¹

Kryengritja në Kosovë kishte tronditur pushtetin ushtarak dhe diplomacinë serbe në arenën ndërkombëtare. Edhe pse e bëri shtetrrëhimin, mizonitë serbe morën erë. Ajo u detyrua t'i marrë disa masa dhe nuk mundi t'i nëpërkëmbte shqiptarët në pakufi.

Duhet theksuar se askush nuk i përkrahu shqiptarët, sidomos ata të Kosovës. Madje, ata pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore u trajtuan edhe më keq se popujt dhe shtetet e mundura të Bllokut Qendror.²²

Kryengritja shqiptare u shtyp me gjak, por jehona e saj ishte shumë e madhe dhe lufta për liri nuk pushoi. Shpirti atdhetar e liridashës i popullit të Kosovës nuk u shua asnjëherë.²³ Pati rënie të luftës kundër pushtetit serb, por kurrë shuarje të plotë të saj. Aspirata për liri dhe bashkim kombëtar gjithmonë ishte e gjallë. Me Kryengritjen e pranverës të vitit 1919 shqiptarët e Kosovës deshën ta hapin derën e lirisë së shumëkërkuar, sidomos nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndej.

Me dekada të tëra, për shkaqe të njohura politike, Serbia ishte alergjike për shkruarjen e historisë së luftës së armatosur, ajo kërkonte të shkruhej historia e nënshtimit të shqiptarëve, kurse kryengritjet në Kosovë më 1919 lanë gjurmë të pashlyera për shumë breza në historinë e luftërave të përgjakshme shqiptaro-serbe. Kryengritja e pranverës e vitit 1919 ishte vazhdimësi e luftës dhe e kryengritjeve të njëpasnjëshme në Kosovë dhe në Shqipëri në përgjithësi kundër Serbisë nga vitet 1912/1913, Kryengritja e shtatorit 1913, mars-prillit 1914, e shkurtit dhe qershorit 1915, të shkurtit e pranverës së vitit 1919, e verës 1920, verë-vjeshtës 1921 etj.

Kryengritja nën udhëheqjen e kryeprogonistëve Azem Bejta dhe Sadik Rama ishte lufta më e lavdishme në Kosovë kundër Serbisë e periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Ndërkaq, luftërat shqiptaro-serbe në territoret e Shqipërisë së 1913-ës në verë të vitit 1920, dhe sidomos në verë-vjeshtë të vitit 1921, janë më të mëdha në përmasa dhe humbje: me dhjetëra mijë të vrarë e të plagosur. Ajo ishte periudha më dramatike e historisë së shqiptarëve.

Ushtri të ndryshme pushtuese kishin sunduar këtë tokë me zjarr dhe hekur, kishin bërë edhe ato krime të panumërta, por ndryshonin nga ato të barbarëve serbë e malazezë. Të parët ushtronin terrorin për ta mbajtur këtë

²¹ AVII, Beograd, Popisnik 4/III, kut. 54, fasc. 3, br. 2743,4786, 4031; Xheladin shala, vep. e cit., 38.

²² Paskal Milo, Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë, 1992, 68.

²³ Sylejman Krasniqi, gaz. "Bashkimi", 17.4.1982, Tiranë, artikulli "Prijës i kryengritjes shqiptare të vitit 1919.

tokë shqiptare të pushtuar, serbët dhe malazeztë kishin synim shfarosjen e popullit shqiptar. Këtij qëllimi nuk ia arritën falë trimërisë shqiptare dhe falë edhe plleshmërisë së nënës shqiptare.²⁴

Të përfundojmë, Kryengritja shqiptare e zhvilluar për disa muaj më 1919, e udhëhequr prej atdhetarëve të shquar Azem Bejtë Galica, Sadik Ramë Gjurgjeviku e viganë të tjerë, deri më tani nuk e ka zënë vendin e merituar në historiografinë tonë. Kjo epope e lavdishme ishte lënë në harresë për mëse 8 dekada, sidomos në Kosovë, megjithëse se ato ngjarje ishin shtylla kryesore të historisë sonë.

Lirisht themi se akti i Kryengritjes së vitit 1919 kundër Serbisë ishte sa heroik aq edhe historik. Me të iu dëshmuar botës se kjo tokë e quajtur Kosovë - Dardania antike, nuk është ajo për të cilën trumbetonte me të madhe Beogradi. Andaj, obligim yni është që t'i përkujtojmë jubiletë e ngjarjeve dhe të figurave madhore të kombit tonë, luftëtarët trima që me gjakun e tyre e skuqën tokën e shtrenjtë shqiptare. Ata, me armë në dorë, shkruan faqe më të lavdishme të historisë së popullit tonë, duke mos lejuar të venitet dhe të shuhet kombi shqiptar.

Dr. Xheladin SHALA

MAY-JUNE 1919 UPRISING IN KOSOVA AGAINST SERBIA AND MONTENEGRO

Summary

The issue of Albanian-Serbian wars has never been entirely and justly enlightened. Therefore, due to the current national interest on the issue, there is an immediate need, scientific first of all, to approach the problem based on archive sources and present it generally as the most daring and glorious part of the history of our people that resisted and sacrificed in war against Serb invader. The Albanian people of Kosova suffered many misfortunes and as a consequence it had enough. The borders of Kosova were violated for many times. The number one cause to the national tragedy of Albanians of Kosova was Serb-Slavism. While Albanians of Kosova tried to create an Albania in its true borders, the aim of Serbia was to eradicate the idea of national liberation and unification of the Albanian people.

Albanian areas being arbitrarily snatched from its trunk in 1913 rose against the invading Serbia six times in five years: 1912, 1913, 1914, 1915 and twice in 1919. The leaders of Kosova at that time were firm to come out proud before history. Undoubtedly, the

²⁴ Skënder Drini, Bajram Curri, Titanë, 1984, 217.

spring 1919 uprising was the most famous Albanian uprising in Kosova between two world wars. It left inerasable traces for generations in the history of bloody Albanian-Serb wars. Let us recall that the Albanian Uprising continued for several months in 1919, under the leadership of notable patriots, such as Azem Bejta, Sadik Rama, Shote Galica e and others – who in any way have not taken the place they deserved in our history. This glorious period was forgotten for more than 8 decades, although they represented major pillars of our history.